REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 94/17
Datë/Datum. 26.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për :	Autoritetin Kontraktues **Komuna Gjilanë**	Kopje:	Paneli Shqyrtues – OSHP **Nr. 94/17**
Nga:	Shefqet Emërllahu – Ekspert teknik – profesional Visar Bibaj – Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën: ,,**Pastrimi i Rrugëve, trotuareve, mirembajtja e parqeve dhe hapsirave publike"**,me nr. të Prokurimit: GI 651-16-052-211.		
Përgjigjeje në ankesë:	OE ,,El-Bau&Vemor"		
Datë:	26.04.2017		

Bazuar ne nenin 113 dhe 114 te LPP-së të Kosovës, ju njoftojm me raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: ,,**Pastrimi i Rrugëve, trotuareve, mirembajtja e parqeve dhe hapsirave publike"**,me nr. të Prokurimit: GI 651-16-052-211, të inicuar nga AK- K. Gjilan, si dhe me përgjigjejen ndaj pretendimeve ankimore te OE ankues ,,El – Bau & Vemor", me numer protokolli 94/17.

Konform nenit 113 dhe 114, pjesa IX e LPP-së, ekspertet shqyrtues te pavarur, kane shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit ne fjale si dhe kerkesesn e AK-së, dhe ka konstatuar me poshte:

AK eshte i thirrur qe pase marrjes se raportit, lidhur me kete procedure te prokurimit perkatesisht pergjigjeve ndaj pretendimeve te perfshira ne ankese, te veproj sipas kerkesave te nenit 115 te LPP-së.

Te bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohët:
1X1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së;
1x1 Autoriteti Kontraktues;
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI I EKSPERTIT TEKNIK

		19.04.2017		21.04.2017		26.04.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 03.04.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **94/17** te parashtruar nga OE **„El Bau-sh.p.k"**me seli në Gjilan, kundër AK –**Komuna Gjilan** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **„Pastrimi i Rrugëve, trotuareve, mirembajtja e parqeve dhe hapsirave publike"**,me nr. të Prokurimit: GI 651-16-052-211.

Konform nenit 113.1, te LPP-seNr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komuna Gjilan.**

N.111,LPP-Operatori Ekonomik Ankues „El-Bau&Vemor" sh.p.k, me seli në Gjilan.

Pikat e Ankesës nga OE **"El-Bau" sh.p.k",** me seli në **Gjilan**, dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues.

Bazuar në nenin 109 lidhur me neni 111 të LPP-së, nenit 9 dhe 10 te Rregullave per parashtrim te ankesave – F03, OE „El – Bau" sh.p.k. Në cilsin të pales së interesuar qe ka interes juridik – material lidhur me këtë lëndë, në përputhje me rrethanat e nenit 108A (pas udheheqjes se preocedures paraprake per zgjidhje te mosmarrveshjes perms kerkeses per rishqyretim tek AK), duke kundershtuar ne tersi: Njoftimin – Letrën standard per tenderuesin e eleminuar OE „El-Bau" sh.p.k. të dt. 20.03.2017, Njoftimin per Dhanje te Kontrates OE „Eco-Higjiena" sh.p.k. ia pergaditur me dt. 17.03.2017, Pergjigjja nr. 16-27774/2 dt. Protokolli 22.03.2017 (nuk eshte nxjerrë vendim siç e percakton neni 108/A par. 10 I LPP-së dhe neni 8 i Rregullores per Parashtrimin e Ankesave – F03) për refuzimin si te pa bazuar te ankeses se OE „El – Bau" sh.p.k. dt. 21.03.2017, i nxjerrë nga Drejtori i Zyres se Prokurimit z. Salih Kqiku, te cilen e kemi pranuar me dt. 03.04.2017, me qëllim ka riperseritur shkeljet e dispozitave te LPP-së dhe legjislacionit sekondar te prokurimit (pretendimeve ankimore) te ngritura ne Kerkesen per Rishqyrtimte dt. 09.11.2016 dhe Ankesen e dt. 02.112.2016 dhe ate shkeljet e listuara si ne vijim:

1. Neni 1, Qëllimi;
2. Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
3. Neni 7, Barazia në trajtim/Jo-diskriminim;
4. Neni 52, Njoftimi i kritereve per dhenie te kontrates;
5. Neni 56, Dispozitat të përgjithshme mbi perzgjedhjen e pjesmarresve dhe Dhenien e Kontratave;
6. Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ;
7. Neni 60, paragrafi1, nenparagrafi1.1, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve;
8. Neni 72, Dokumentacioni dhe informacioni shtese;
9. Neni 18.5, i Rregullores per Udhezuesin Operativ per prokurim publik;
10. Nnei 26.1, 26.2 i Rregullave per Udhezuesin Operativ per prokurim publik;

11. Nnei 26.6, pika 1.3, 1.4 i Rregullave per Udhezuesin Operativ per prokurim publik;
12. Nnei 26.8, i Rregullave per Udhezuesin Operativ per prokurim publik;

Si dhe akteve nenligjore nga legjislacioni sekondar qe plotsojne dhe sqarojne dispozitat e lartshenuara te LPP-së.

Shkelje te Vendimit te PSH. Nr. 446/16 të dt. 25.01.2017

Përveq shkeljeve te dispozitave te lartshenuara me rastin e procedures se Ri-vlersimit jane kryer shklje te dyfishta ngase AK nuk iu eshte permbajtur Vendimit te PSH. Nr. 446/16 te OSHP-së, qe ka pusur detyrim ligjor ngase me ane te ketij vendimi eshte vertetuar se te gjitha pretendimet ankimore te OE ,,El Bau" siç u ceken me larte jane te bazuara dhe se i njejti eshte i pergjegjshum, ndersa per OE ,,Eco higjiena" te cilin AK e kishte zgjedhur per dhenie te kontrates eshte vertetuar se nuk eshte i pergjegjshum pasi qe nuk ka plotsuar kriterin e specifikuar te kerkesave e mundesive teknike dhe profesionale siç jane kerkuar ne dosjen e tenderit dhe njoftimit per kontrate. Eshte vertetuar se AK ka bere shkelje te nenit 59.4 te LPP-së ne lidhje me rastin konkret – vlersimin si te pergjegjshum te ofertes se OE ,,Eco – Higjiena" dhe njekohesisht dhenien e kontrates, dhe per shkak te shkeljeve dhe mosrespektim te dispozitave ligjore hde me Vendim te PSH nr. 446/16 kishte urdheruar AK qe te anuloj vendimin per dhanje te kontrates OE ,,Eco-Higjiena", dhe lenden ta ktheje ne Ri-vlersim dhe brenda 10 ditesh ta informoj Panelin Shqyrtues me te gjitha veprimet e ndermarra lidhur me kete prokurim, **gje te cilen nuk ka ndodhur per faktin se Ri-vlersimi qellimisht eshte sterzgjaturper afro dy muaj.**

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Përmbajtja e arsyetimit te dhene ne Leteren Statandarde per tenderuesin e eleminiuar te OE ,,El – Bau" sh.p.k. te dt. 20.03.2017, (perseritu nga arsyetimi paraprak per eleminim) tutje ne te cilen shkruan se jemi eleminuar per arsye se gjoja nuk kemi ofruar deshmi te mjaftueshme se posedojm **referenca per mirmbajtjen dhe pastrimin e hapsirave publike-gjelbruese**, po ashtu ka bere shkelje te ligjit neni 52.3 , ngase ne dosjen e tenderit ne piken 9.1.1 te FDT-së nuk eshte kerkuar nje gje e tille, por vetum kerkohen deshmi **referenca kontrata per pune te ngjajshme,** pertej kesaj ky arsyetim paraqet vlersim te rrejshum/mashtrues qe rezulton me vertetim te gabueshum te gjendjes faktike ngase siç mund te vertetohet nga dokumentet qe perbejne dosjen e tenderit te OE ,,El Bau" **ekzistojn deshmite dokumnetare per 4 kontrata te shoqruara me referenca , siq ka mundesi qe heren e pare gjate administrimit te procesit te vlesrimit ka vlersuar se i kemi referencat te cilat lidhen me plotsimin e kerkesave mbi mundesit teknike dhe profesionale ndersa heren e dyte gjae ri-vlersimit nuk jane.** Mirepo me kete vendim konsiderojme se ka si qellim shpierjen e dhenijes se kontrates operatorit tjeter pjesmarres Eco-Higjena.

Andaj duke pasur parasysh kontekstin e gjendjes faktike dhe ligjore bazuar ne faktet e paraqitura si me lart jane te argumentuara me fakte te bazuara me saktesi faktike dhe ligjore duke perfshi edhe vendimin e formes se prere / ekzekutues , Vendimi i PSh . nr 446/16 AK ka vepruar ne kundershtim me aplikimin e dispozitave te lartshenuara te LPP-së dhe akteve nenligjore dhe ka bere vertetimin e gabueshum te gjendjes faktike duke mos vlersuar faktet vendimtare qe si pasoj nga shkeljet e pretenduara ka rezultuar me demtimin e konzorciumit te OE ,,El Bau & Vemor" . kerkojm nga OSHP – Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit e marrjes ne konsiderate duke ju dhene peshe te gjitha fakteve te paraqitura ne ankese, dhe te marre ketë:

VENDIM:

MIRATOHET - si e bazuar ankesa e OE ,,El-Bau&Vemor"

ANULOHET - Njoftimi per dhanje te kontrates i dt. 17.03.2017 dhe te vendoset VERTETOHET si qeshtje e shqyrtuar dhe gjykuar ,,RES JURIDIKATA" ne baze te Vendimit te PSH. Nr. 446/16 ngase nga AK jane perseritur arsyetimet e njeta per lenden e njete te cilat jane gjykuar me ane te ketij Vendimi;

OBLIGOHET AK qe gjate ri-vlersimit te marre masa krigjuese dh eta shperblej me Kontrate OE ,,El Bau" si ofertues I vetum I pergjegjshem me çmimin me te uet qe plotson te gjitha kriteret e kerkuara ne dosjen e tenderit. .

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratënë KRPP :	03.08.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur-Ritenderim
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Shërbim/vlerë e madhe
Afati i fundit për pranim të *tenderëve*	23.08.2016
Data e hapjes së ofertave sipas procesverbalit	23.08.2016
Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së, pas ri-vleresimit	17.03.2017

Kriteret për vlerësim

Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Zotimin e OE se i plotëson kërkesat për të konkurruar sipasLigjit 04/L-042, Neni 65.
2. Dëshminë nga gjykata ekonomike se OE sipas nenit 65 të LPP.
3. Dëshminë se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Deklarata nën betim që tenderuesi i plotëson kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit 04/L-042, Neni 65, **(e cila është pjesë e dosjes së tendserit) e nënshkruar dhe vulosur,**
2. Vërtetim nga gjykata ekonomike (jo me te vjetër se tre muaj) se OE nenit 65 të LPP ***-origjinal ose i noterizuar për kompanin e cila propozohet për shpërblim të kontratës***
3. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit.- ***origjinal ose i noterizuar për*** *kompanin e cila propozohet për shpërblim të kontratës.*

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.
2. Certifikata e TVSH-së.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me tëcilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend **(Kopja e certifikatës së biznesit).**

2. Çertifikata e TVSH-së – **kopje.**

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare:

1. Qarkullimi bankar në tri vitet e fundit 600,000.00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Qarkullimi bankar në tri vitet e fundit 600,000.00 € - të dëshmohet me qarkullim bankar ose me raporte të auditorëve të pavarur dhe të licencuar.

Kërkesat mbimundësitë teknikedhe/ose profesionale:

1. Projekte apo kontrata të ngjajshme të realizuara në tri vitet e fundit.
2. Mekanizimi i nevojshëm për këtë lloj shërbimi.

- dy cisterna të ujit me kapacitet 6000 litra.
- makina për krasitje, kositje,ujitje,formësim dhe dekorim.

3. Stafi punues- të ketë të punsuar së paku 60 punëtor.
4. Të ketë kontratë për furnizim me ujë higjienik për larjen e rrugëve nga Kompania Publike për Menaxhimin e resuseve ujore.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Lista e kontratave të ngjajshme të realizuara në tri vitet e fundit minimum dy copë ku duhet të dëshmohet me raporte mbi pranimin e shërbimeve ose referenca ku qart duhet të ceket emri i projektit koha e realizimit të shërbimit vendi dhe vlera e projektit - **duhet të jetë e nënshkruar vulosur – origjinal.**
2. Mekanizmi i nevojshëm për këtë lloj veprimtarie Cisternat duhet të jen në pronësi të ofertuesit dhe të jen me regjistrim valid, pjesët tjera të makineris të dëshmohen me foto dhe me shkres mbi posedimin e të njejtave.
3. Lista e stafit të jetë origjinale e nënshkruar dhe e vulosur.
4. Të ketë kontratë për furnizim me ujë higjienik për larjen e rrugëve nga Kompania Publike për
5. Menaxhimin e Resuseve Ujore- **kontrata duhet të jetë origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga palët.**

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total	Vërejtje
1.	El Bau & Vemor	Gjilanë	886,287.54 €	JO
2.	Eko - Higjiena	Gjilanë	895,089.92 €	JO

*Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën:*23.08.2016*, konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë dy (2)përfaqësuestë OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni ri- vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit ri-vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej treanëtarëve, si në vijim:
- Kryetari komisionit – Ramadan Gashi
- Anëtar i komisionit – Bashkim Bunjaku
- Anëtari komisionit – Avdirrahim Musliu

Data e mbarimit të ri-vlerësimit:..... 15.03.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....16.03.2017

Deklarata e komisionit vlerësues:

OE i rekomanduar per dhenje te kontrates: "Eco-Higjiena" – Gjilan - 895,089.92 €

Analiza dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues (N. 113, 114)

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi hyres: Pretendimet ankimore, në tërësi janë trajtuar – shqyrtuar nga eksperti teknik – profesional z. Emerllahu, pasi që i njejti të gjitha shkresat e lëndës deri në datën e protokollimit të këtijë raporti i ka patur në posedim.

Sqarimi nr.1- Autoriteti Kontraktues - **K. Gjilan,** per kwte aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është shërbim, kontratë publike kornizë (36 muaj) me vlerë të madhe, operatori ekonomik ankues: **"El-Bau&Vemor"shpk,** ka parashtruar ankesë në këtë aktivitet të prokurimit kundër njoftimit për dhënje të kontratës, konkretisht kundër arsyetimit të eleminimit të theksuar në letrën standarde, pas ri-vleresimit te ofertave, ku AK - K. Gjilan, ka cituar:
Ne Leteren Statandarde per tenderuesin e eleminiuar te OE ,,El – Bau" sh.p.k. te dt. 20.03.2017, (perseritur nga arsyetimi paraprak per eleminim) tutje ne te cilen shkruan se jemi eleminuar per arsye se gjoja nuk kemi ofruar deshmi te mjaftueshme se posedojm **referenca per mirmbajtjen dhe pastrimin e hapsirave publike-gjelbruese**, po ashtu ka bere shkelje te ligjit neni 52.3 , ngase ne dosjen e tenderit ne piken **9.1.1 te FDT**-së kerkohen:

1. **Kërkesa**: Projekte apo kontrata të ngjajshme të realizuara në tri vitet e fundit.

2. **Dëshmia:** Lista e kontratave të ngjajshme të realizuara në tri vitet e fundit minimum dy copë ku duhet të dëshmohet me raporte mbi pranimin e shërbimeve ose referenca ku qart duhet të ceket emri i projektit koha e realizimit të shërbimit vendi dhe vlera e projektit - duhet të jetë e nënshkruar vulosur – origjinal.

Kunder të njejtit arsyetim, parashtruesi i ankeses OE **"El-Bau&Vemor"shpk** , 21.03.2017 i drejtohen AK-së me kërkesë për rishqyrtim me pretendimet ankimore se AK-K. Gjilan, me rastin e elminimit ka bërë shlelje të dispozitave të LPP-së dhe atë:

Neni 1, Qëllimi;

Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni **7**, Barazia në trajtim/Jo-diskriminim;
Neni 56, Dispozitat të përgjithshme mbi perzgjedhjen e pjesmarresve dhe Dhenien e Kontratave;
Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ;
Neni 72, Dokumentacioni dhe informacioni shtese;
Si dhe akteve nenligjore nga legjislacioni sekondar qe plotsojne dhe sqarojne dispozitat e lartshenuara te LPP-së.

AK- K. Gjilan, ka dhene pergjigjjen me nr. 16-27774/2 dt. Protokolli 22.03.2017 (nuk eshte nxjerrë vendim siç e percakton neni 108/A par. 10 I LPP-së dhe neni 8 i Rregullores per Parashtrimin e Ankesave – F03) për refuzimin si te pa bazuar te ankeses se OE ,,El – Bau" sh.p.k. dt. 21.03.2017, i nxjerrë nga Drejtori i Zyres se Prokurimit z. Salih Kqiku, te cilen e kemi pranuar me dt. 03.04.2017, me qëllim ka riperseritur shkeljet e dispozitave te LPP-së dhe legjislacionit sekondar te prokurimit (pretendimeve ankimore) te ngritura ne Kerkesen per Rishqyrtim. **Eksperti shqyrtues bazuar ne vendimin e AK te dt. 22.03.2017, sqaron se AK nuk ka nxjerrë vendim siç e percakton neni 108/A par. 10 i LPP-së dhe neni 8 i Rregullores per Parashtrimin e Ankesave – F03) dhe fare nuk e ka shqyrtuar pretendimin ankimor lidhur me kriterin e listuar në piken 9.1 pozicioni nr.2, të FDT-së, edhe pse ne baze te rregullores per paraqitje te kerkeses per rishqyrtim prane AK , parashtrim te ankesave pran OSHP-së dhe vlera e tarifave te ankesave, F03 te KRPP-së, ka qene i obliguar te shqyrtoj te gjitha pretendimet ankimore duke cekur arsyet e refuzimit.**

Sqarimi nr.2 - Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë me kriterin e listuar në piken 9.1.1 te FDT-së, ku AK – K. Gjilan, tekstualisht ka kërkuar:

1. **Kërkesa**: Projekte apo kontrata të ngjajshme të realizuara në tri vitet e fundit.
2. **Deshmia:** Lista e kontratave të ngjajshme të realizuara në tri vitet e fundit minimum dy copë ku duhet të dëshmohet me raporte mbi pranimin e shërbimeve ose referenca ku qart duhet të ceket emri i projektit koha e realizimit të shërbimit vendi dhe vlera e projektit - duhet të jetë e nënshkruar vulosur – origjinal.

Lidhur me pretendimin ankimore që ka të bëjë me kërkesësn e përcaktuar në pikën **9.1.1** të FDT-së, **eksperti shqyrtues vlerson,** se parashtruesi i ankeses në shkresa të ofertës posedon deshmite dokumnetare per 4 kontrata te shoqruara me referenca, te cilat kane qene te dokumentura qe heren e pare gjate administrimit te procesit te vlesrimit ku edhe vete AK ka vlersuar se i ka referencat te cilat lidhen me plotsimin e kerkesave mbi mundesit teknike dhe profesionale ndersa tani gjate ri-vlersimit thote se nuk jane. ***Eksperti Shqyrtues bazuar ne ate qe u tha me lart, sqaron se AK – K. Gjilan, nuk e ka respektuar*** **vendimin e PSH. Nr.446/16 i dt. 25.01.2017, neni 104, neni 56, neni 59, paragarfi 2 dhe 4, neni 60 paragarfi 1.1, neni 72 lidhur me neni 1, neni 6 dhe neni 7.**

Sqarimi nr.3 - Ne pretendimin tjeter ankimore –
Kërkesat mbimundësitë teknikedhe/ose profesionale, neni 9.1 pika 2 te FDT-së.

Kërkesa: Mekanizimi i nevojshëm për këtë lloj shërbimi.
- dy cisterna të ujit me kapacitet 6000 litra.
- makina për krasitje, kositje,ujitje,formësim dhe dekorim.

Deshmia: Mekanizmi i nevojshëm për këtë lloj veprimtarie Cisternat duhet të jen në pronësi të

ofertuesit dhe të jen me regjistrim valid, pjesët tjera të makineris të dëshmohen me foto dhe me shkres mbi posedimin e të njejtave. ***Eksperti Shqyrtues sqaron*** **se dëshmitë e paraqitura nga OE ankues si të tilla e plotesojnë kërkesen e AK-së, të paraparë ne pikën 9.1, pozicioni 2, të FDT-së, poashtu dhe kjo pike eshte trajtuar me vendimin e PSH. Nr. 446/16 i dt. 25.01.2017**

Sqarimi nr.4 - OE i rekomanduar per kontrate „**Eco-Higjiena**" është i papërgjegjshëm. ***Eksperti Shqyrtues sqaron se edhe kjo pike ankimore eshte trajtuar permes*** **vendimit te PSH. Nr. 446/16 i dt. 25.01.2017**

Sqarimi nr.5- Ne kontest te gjendjes faktike dhe te bazes ligjore gjate fazes se shqyrtimit te pretendimeve ankimore, **Eksperti Shqyrtues vlerson se qendron pretendimi ankimori OE „El Bau&Vemor"**, sepse **AK – K. Gjilan,** nuk ka vepruar konform LPP-se, parimeve kryesore te prokurimit, konkurrences, efikasitetit & efektivitetit, drejtesis/mosdiskriminimit, kushteve te barabarta ne menyre te drejt dhe me qellim te zgjidhjes se ligjshme dhe te drejt te aktivitetit te prokurimit, si dhe nuk sigurojne qe jane zbatuar drejt dhe ligjshum rregullat e prokurimit publim andaj edhe nuk sigurojn menyren efikase, transparente dhe ekonomike te shfrytezimit te drejt te fondeve. **AK – K. Gjilan ka bere shkelje te LPP-së, nenit 26.8 te Rregullave te Udhezuesit Operativ per prokurim publik (me tej Rr. UOPP) nenit 69.4, neni 104, neni 56, neni 59, paragarfi 2 dhe 4, neni 60 paragarfi 1.1, neni 72 lidhur me neni 1, neni 6 dhe neni 7, andaj ky process i prokurimit duhet te vlersohet si qeshtje e shqyrtuar dhe gjykuar ne baze te Vendimit te PSH. Nr. 446/16 i dt. 25.01.2017, ngase nga AK jane perseritur arsyetimet e njeta per lenden e njete te cilat jane gjykuar me ane te ketij Vendimi.**

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Eksperti shqyrtues bazuar nësqarimet e cekura nëraport mendon që Autoriteti Kontraktues – **K. Gjilan**, për aktivitetin e prokurimit: „**Pastrimi i Rrugëve, trotuareve, mirembajtja e parqeve dhe hapsirave publike"**, me nr. të Prokurimit: GI 651-16-052-211, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.

Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta anulojë vendimin e AK-së, njoftimin për dhënie të kontratës, dhe propozon që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në **Ri - vlerësim.**

Gjithashtu eksperti shqyrtues rekomandon panelin shqyrtues që të aprovoj ankesen e operatorit ekonomik **„El-Bau&Vemor"shpk**, si të **bazuar.**